

Ne fokus/ Tifozet Kuqezi festojne 10 vjetorin ne Prishtine

nga AlbaniaSoccer

E premte, 27 Dhjetor 2013 22:24



Tifozet kuqezi do te festojne ne daten 28 dhjetor ditelindjen e 10-te. Ndryshe nga sa kane bere me pare kur kane festuar ne stadium apo para ndeshjeve, tani kane zgjedhur Prishtinen. Festa do te jete madheshtore dhe pjesemarres ne te do te jene personalitete te ndryshme nga bota e sportit dhe me se shumti nga futbollit. Tifoze nga e gjithe Shqiperia jane nisur drejt Prishtines dhe atmosfera pritet te jete e jashtezakonshme. Lorik Cana do te jete aty dhe bashke me te edhe shume futbolliste te tjera te Kombetares Shqiptare apo dhe sportiste te njohur. Koncert madheshtor dhe gjithcka ne ngjyrat kuqezi. Tifozet kane menduar ne detaje kete organizim per ditelindjen e tyre te 10-te.